



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 40, datë 18 .10. 2012

PËR

“NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË SË TIRANËS PËR VITIN 2012”

Në mbështetje të nenit 19, pika 2 dhe 9 dhe nenit 32, gërma “dh” të ligjit nr. 8652 datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pikën 97 të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06. 02. 2012 për “Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr. 25 datë 28.12.2011 për “Miratimin e Buxhetit të vitit 2012”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 692, datë 12.10.2012, për “Një shtesë në buxhetin e vitit 2012 të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Bashkinë e Tiranës për dekorimin e qytetit në muajin nëntor me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I

1. Të miratojë shtesën në fondin e shpenzimeve operative të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2012, në përputhje me fondin e miratuar Këshilli i Ministrave për Bashkinë e Tiranës, në programin, shumën, strukturën dhe artikullin si më poshtë:

**Programi i Kulturës dhe Turizmit
Gr.00, Tit.08250, Kap.1, Art.602
Aparati i Bashkisë**

Dekorimi i qytetit me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë 15,996,288 lekë.

(pesëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtëmijë e dyqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Prokurimeve dhe Drejtoria e Financës për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI